



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

Në përputhje me nenin 1, paragrafi 1.3, pika (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Duke pasur parasysh dispozitat e nenit 5 paragrafi 5.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë

Me qëllim të krijimit dhe vendosjes së rregullave për regjistrimin e organizatave të punëtorëve në përputhje me dispozitat e konventave ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë sindikale,

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2008

PËR

RREGULLIMIN DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E SINDIKATAVE

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e kushteve dhe kriteret që Sindikatat duhen t'i plotësojnë për t'u regjistruar nga organi përgjegjës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) si dhe përcaktimin e procedurave të domosdoshme për regjistrimin e tyre.

Neni 2

Kriteret për regjistrimin e sindikatave

- (1) Organizatatë e punëtorëve (Shoqatatë sindikale , federatat dhe konfederatat) për zyrtarizimin e fushveprimit të tyre, duhet të aplikojnë për regjistrim në Organin përgjegjës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale .
- (2) Sindikatat mund ta fillojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e vet, vetëm pasi të jenë regjistruar në MPMS.
- (3) Shoqata sindikale , si njësi themelore organizative, mund të regjistrohet në MPMS, nëse ka së paku 25 (njëzetepesë) anëtar sindikal.
- (4) Federata sindikale, mund të regjistrohet në MPMS, nëse në kuadër të saj ka së paku dy shoqata sindikale të veprimtarive të njëjta ose të ngjashme, anëtarësia e të cilave është së paku 10% e të punësuarve në nivel të vendit.
- (5) Konfederata sindikale, mund të regjistrohet në MPMS, nëse në kuadër të saj veprojnë së paku dy federata sindikale të veprimtarive të ndryshme , anëtarësia e të cilave është së paku 10% e të punësuarve në nivel të vendit.

Neni 3

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

- (1) Sindikata në cilësinë e shoqatës , federatës apo të konfederatës me rastin e aplikimit për tu regjistruar në MPMS , krahas kërkesës me shkrim duhet të prezentoj edhe këtë dokumentacion :
1. Statutin e sindikatës (shoqatës , federatës apo të konfederatës).
 2. Procesverbalin e mbledhjes konstituive të sindikatës ,
 3. Dokumentin për emërtimin , selinë, llogon dhe vulat sindikatës,
 4. Regjistrin e anëtarëve sindikal , duke përfshirë emrin , mbiemrin, ditëlindjen numrin e letërnjoftimit , nënshkrimet dhe adresat e anëtarëve sindikal ,
 5. Deklaratat për anëtarësim të anëtarëve sindikal në sindikatë dhe

6. Të dhënat e sakta për udhëheqjen sindikale , duke përfshirë emrin, mbiemrin, ditëlindjen, numrin e letërnjoftimit, telefonit dhe nënshkrimet e anëtarëve të udhëheqësisë sindikale ,

Neni 5

Ndryshimi i emrit dhe udhëheqjes sindikale

(1) Sindikata e regjistruar në organin përgjegjës të MPMS mund të kërkoj ndryshimin e emrit dhe konfirmimin e udhëheqjes së re sindikale .

(2)Për ndryshimin e emrit dhe konfirmimin e udhëheqësisë së re sindikale , sindikata duhet të dorëzoj këto dokumente :

1. Procesverbalin organit të sindikatës në të cilin kanë marrë pjesë së paku dy të tretat e anëtarëve të cilët kanë qenë pjesëmarrës në kuvendin e parë të regjistruar në MPMS.
2. Vendimin e organit të sindikatës për zgjedhjen dhe emërimin të udhëheqësisë së re sindikale si dhe
3. Vendimin për ndryshimin e emërimit të sindikatës.

Neni 7

Procedurat e regjistrimit

(1) Kërkesa për regjistrimin e sindikatës së bashku me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet ne Departamentin Ligjor të MPMS-së si Organ përgjegjës i kësaj ministrie , për regjistrimin e sindikatave .

(2) Organi përgjegjës i MPMS, nëse vlerëson se janë përmbushur kushtet dhe kriteret për regjistrim të përcaktuara me akt nënligjor , në afat prej 30 ditësh nga dita e aplikimit për regjistrim, nxjerrë vendim në formë të shkruar, për regjistrimin e sindikatës.

(3) Organi përgjegjës i MPMS-së, krahas nxjerrjes së vendimit për regjistrim , në afat prej 15 ditësh , sindikatës së regjistruar i lëshon një certifikatë lidhur me ushtrimin e veprimtarisë sindikale.

(4) Në rastet kur sindikata nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara për regjistrim, organi përgjegjës i MPMS, nxjerr vendim për refuzimin e regjistrimit të sindikatës, duke informuar aplikuesin për arsyet e refuzimit .

(5) Në vendimin për refuzimin e regjistrimit të sindikatës, përfaqësuesi sindikal mund të ushtroj ankesë tek Ministri i MPMS –së në afatin prej 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit .

(6) Kundër vendimit të Ministrit të MPMS-së si organ administrativ i shkallës së dytë , pala e pakënaqur, në afat prej 30 ditësh, mund të ushtroj padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës kompetente, nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 8

Ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Udhëzimi Administrativ , mund t'i iniciojnë Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale në koordinim dhe konsultim me përfaqësuesit e sindikatave të regjistruara në MPMS.

Neni 9

Zbatimi i Udhëzimit Administrativ

Për zbatimin e drejtë dhe të plotë të dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ , do të përkujdeset Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili në koordinim me Departamentin Ligjor të kësaj ministrie , mund të nxjerrë vendime apo akte tjera të cilat janë në funksion të zbatimit të këtij akti nënligjor.

Neni 10

Shfuqizimi i dispozitave ligjore

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr.22/2001 mbi regjistrimin e sindikatave si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore e cila është në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ .

Neni 11

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

Prishtinë , Prill 2008

Ministri i MPMS-së

Nenad Rasic